

Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution

Prishtinë, më 23 dhjetor 2019

Z. Bahri Hyseni, Kryesues
Këshilli Prokurorial i Kosovës
Rr. "Luan Haradinaj". nr. 16/1
Zona II. Kategoria II

LETËR REKOMANDIMI

Ankesa nr. 337 / 2019
kundër
Këshillit Prokurorial të Kosovës

I nderuari z. Hyseni,

Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit dhe në bazë të nenit 10 të Ligjit nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike,¹ më 16 prill 2019, ka pranuar ankesë nga z. R.M., parashtruar kundër Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK), për qasje të kufizuar në dokumente publike.

Në bazë të informatave që Avokati i Popullit i ka në dispozicion, ankuesi ka aplikuar në konkursin e datës 25 janar 2019, i shpallur nga KPK-ja për pozitën: Zyrtar për mbrojtje të viktimave, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në Mitrovicë. Pas njoftimit për përzgjedhjen përfundimtare të kandidatit të suksesshëm, ankuesi, më 14 mars 2019, ka paraqitur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, përkatësisht *për qasje në testin me shkrim, në procesverbalin e intervistës verbale dhe në pikët e kandidatëve të suksesshëm.*

Më 2 prill 2019, ankuesi është ftuar në zyrat e KPK-së dhe i është lejuar qasja në testin e tij me shkrim, por nuk i është dhënë kopja e testit, ndërsa nuk i është lejuar qasja në procesverbalin e intervistës së tij, si dhe në pikët totale të kandidatëve të përzgjedhur në listën e ngushtë të konkursit në fjalë.

Më 13 maj 2019, Avokati i Popullit iu ka drejtuar me shkresë KPK-së, duke kërkuar informacione për veprimet që i ka ndërmarrë dhe për veprimet që planifikon t'i ndërmarrë KPK-ja, përkitazi me kërkesën e ankuesit.

Meqenëse KPK-ja nuk ka dërguar përgjigje në këtë shkresë, Avokati i Popullit, më 24 qershor 2019, iu ka drejtuar përsëri KPK-së. Më 10 korrik 2019, Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga KPK-ja, përmes së cilës është njoftuar për veprimet që KPK-ja i ka ndërmarrë

¹ Ligji nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike ka hyrë në fuqi më 19 korrik 2019, ndërsa kërkesa e ankuesit është paraqitur para hyrjes në fuqi të ligjit të ri.

për trajtimin e kërkesës së ankuesit. Ndër të tjera, KPK-ja ka njoftuar se, pas pranimit të kërkesës së ankuesit për qasje në dokumente publike, e ka kontaktuar ankuesin (kërkuesi i dokumentit), me ç' rast e ka njoftuar se ai mund të shkojë në zyrat e KPK-së për ta realizuar qasjen, mirëpo ankuesi ka kërkuar nëse paraqitja e tij në zyrat e KPK-së mund të bëhej më 18 mars 2019, në orën 10, meqenëse ndodhej jashtë vendit. KPK-ja më tutje ka njoftuar se ankuesi nuk është paraqitur as më 18 mars 2019. Megjithatë ankuesit iu ka lejuar qasja më 1 prill 2019, kur ankuesi ishte paraqitur për intervistë për një pozitë tjetër të shpallur nga KPK. Po ashtu, përmes përgjigjes së datës 10 korrik 2019, KPK-ja e ka dërguar edhe kopjen e kërkesës së ankuesit, në të cilën ankuesi ka nënshkruar se e ka realizuar qasjen në testin me shkrim, por nuk i është dhënë kopja e tij, si dhe nuk e ka realizuar qasjen në procesverbalin e intervistës.

Më 26 gusht 2019, Avokati i Popullit iu ka drejtuar përsëri me shkresë KPK-së, duke e njoftuar se, atë që kërkuesi i dokumentit e ka shkruar dhe e nënshkruar në kërkesën e tij drejtuar KPK-së, pas lejimit të qasjes së kufizuar, është në fakt vetë **baza e ankesës së parashtruar te Avokati i Popullit**, me të cilën ankuesi pretendon se i është kufizuar e drejta për qasje në dokumentet e kërkuara. Po ashtu, Avokati i Popullit ka kërkuar të njoftohet për bazën ligjore për kufizimin e qasjes në kërkesën e ankuesit.

Më 11 shtator 2019, Avokati i Popullit mori nga KPK-ja pothuajse përgjigjen e njëjtë me atë të datës 10 korrik 2019, më ç' rast u njoftua se KPK-ja është bazuar në nenin 17, paragrafi 2, nënparagrafi 2.6, dhe në nenin 14, paragrafi 3.2, të Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, dhe se KPK-ja konsideron se ka vepruar në përputhshmëri të plotë me ligjin.

Avokati i Popullit vëren se kërkesa e ankuesit ka të bëjë me qasjen në *testin me shkrim; në procesverbalin e intervistës dhe në pikët totale të kandidatëve të suksesshëm*, për procedurën e rekrutimit në konkursin e datës 25 janar 2019, i shpallur nga KPK-ja për pozitën: Zyrtar për mbrojtje të viktimave, Zyra për Mbrojtje dhe Ndihmë të Viktimave në Mitrovicë. Siç shihet, kërkesa ka të bëjë me qasjen në dokumentet dhe në të dhënat që i përkasin kërkuesit të dokumentit, si dhe në listën përfundimtare të kandidatëve me pikët totale, e cila do të duhej të ishte publike.²

Po ashtu, Avokati i Popullit vëren se kërkesa e ankuesit për qasje në dokumente publike është bërë në kohën kur ishte në fuqi Ligji nr. 03/L-215 për Qasje në Dokumente Publike (14 mars 2019) dhe se KPK-ja ka dështuar të veprojë sipas nenit 7 (paragrafët 8 dhe 9), nenit 11 (paragrafët 1 dhe 2), si dhe nenit 13 (paragrafi 2), me rastin e lejimit për qasje të pjesshme në testin me shkrim të ankuesit, si dhe të refuzimit për qasje në procesverbalin e intervistës. Po ashtu, KPK-ja ka dështuar të veprojë sipas Ligjit nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike, gjegjësisht nenit 14, paragrafët 1, 2, 3, dhe nenit 17, paragrafët 7 dhe 8.

Avokati i Popullit vëren se KPK-ja në përgjigjet në shkresat e Avokatit të Popullit i referohet Ligjit nr. 06/L-081, gjegjësisht nenit 17, paragrafi 2.2.6, por që në fakt nuk e argumentojnë zbatimin e kësaj dispozite, sepse mungon vendimi i formës së shkruar me arsyetimin në të

² Lista mund të publikohet me kode duke mos i dhënë emrat e kandidatëve të tjerë, me përjashtim të emrit dhe mbiemrit të kandidatit të suksesshëm të përzgjedhur.

cilin argumentohet testi i dëmit dhe i interesit publik. Për më tepër, Avokati i Popullit konstaton se KPK-ja ka dështuar ta zbatojë edhe Ligjin nr. 05/L -031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht nenet 5, 9, 13 dhe nenin 92.

Meqenëse kërkesa e ankuesit ka të bëjë me të dhënat e tij, KPK-ja është dashur ta ketë parasysh edhe Ligjin nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, përkatësisht nenin 11, me të cilin përcaktohen informimi transparent, komunikimi dhe modalitetet për ushtrimin e të drejtave të subjektit të të dhënave; si dhe nenin 14, me të cilin përcaktohet e drejta për qasje nga subjekti i të dhënave.


Nga sa u tha më lart dhe nisur nga parimet themelore të së drejtës për qasje në dokumente publike, që dalin nga LQDP-ja, e drejta për qasje në dokumente publike e secilit person, garantimi dhe përmbushja e kësaj të drejte nga institucionet publike përbën një prej themeleve të institucioneve demokratike dhe transparente, rrjedhimisht, Avokati i Popullit i

REKOMANDON

Këshillit Prokurorial të Kosovës

- *Të vendosë në kërkesën e ankuesit për qasje në dokumentet e kërkuara në pajtim me Ligjin 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, (...) duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerrni lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit

Kopje: Z. Lavdim Krasniqi, drejtor i Sekretariatit, Këshilli Prokurorial i Kosovës.